



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_276_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_420_06_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_420_06_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Behxhet Mustafa (shifra e konsumatorit DPR – 28512) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 24.11.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.11.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 03.12.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë konstatuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik, ku janë marrë shënimet e njehsorit elektrik të vjetër dhe të ri.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0896112 të datës 03.12.2007

- Me datë 23.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrimin e njehsorëve elektrik kanë larguar nga matja e konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 6174874, dhe kanë vendosur për matje të konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 89815767.

Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 001663 date 23.01.2009

- Me datë 07.03.2008 punëtorët e autorizuar për kontrollimin e njehsorëve elektrik në qendrën e kalibrimit, kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik me nr. 6174874, dhe kanë konstatuar se vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar, të hapura e të mbyllura, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, bobina e rrymës është e këputur-djegur, numëruesi i njehsorit është i manipuluar.
Provë: Procesverbali nr. 21/7 të datës 07.03.2008
- Me datë 17.09.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë vizituar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse, profilin e kabllit furnizues, siguresat etj.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 168487 i datës 17.09.2008
- Në periudhën 09/2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrimin e njehsorëve elektrik kanë larguar nga matja e konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 89815767, dhe kanë vendosur për matje të konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 4694080. Ndërrimi i njehsorit elektrik është bërë me kërkesë të konsumatorit.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 008169
- Me datë 23.10.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06778 në vlerë prej 1,600.25 €
Provë: Fatura DPR08HP06778 e datës 23.10.2008
- Me datë 18.11.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 24.11.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalet e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 24.11.2009
- Me datë 23.11.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_420_06_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

